

20080891668

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E LIGJIT PËR MUZETË

Neni 1

Në Ligjin për muzetë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04), titulli i Kreut XII "Dispozita ndëshkuese" zëvendësohet si vijon: "Dispozita për kundërvajtje".

Neni 2

Në nenin 45 paragrafin (1) fjalët: "Me dënim me para prej 100 000 deri më 200 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse: "zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 3 000 euro deri më 5 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili":

Në paragrafin (2) fjalët: "Me dënim me para prej 10 000 deri më 30 000 denarë do të dënohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës në personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 800 euro deri më 1 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik".

Në paragrafin (3) fjalët: "Me dënim me para prej 10 000 deri më 50 000 denarë për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni do të dënohet tregtari individ: "zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 800 euro deri më 1 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni edhe tregtarit individ".

Në paragrafin (4) fjalët: "Me dënim me para prej 10 000 deri më 30 000 denarë për kundërvajtjen nga neni (1) pika 10 të këtij neni do të dënohet edhe personi fizik: "zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 500 euro deri më 1 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pika 10 të këtij neni edhe personit fizik".

Paragrafi (5) ndryshon si vijon:

"Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pika 10 të këtij neni personit juridik mund t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim të sendeve të cilat janë fituar me kryerjen e kundërvajtjes".

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pika 10 të këtij neni personit fizik mund t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskim të sendeve të cilat janë fituar me realizimin e kundërvajtjes".

Neni 3

Pas nenit 45 shtohen dy nene të ri 45-a dhe 45-b si vijojnë:

"Organi për kundërvajtje"

Neni 45-a

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje kumton organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e kulturës (në tekstin në vijim: Organi për kundërvajtje).

(2) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, para Organit për kundërvajtje e mban Komisioni për vendimmarrje sipas kundërvajtjes (në tekstin në vijim: Komision për kundërvajtje) i formuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e kulturës.

(3) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga persona të autorizuar zyrtarë të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e kulturës, prej të cilëve njëri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit për kundërvajtje.

(4) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga tre anëtarë prej të cilëve:

- dy juristë të diplomuar, prej të cilëve njëri me provim të dhënë të jurisprudencës me pesë vjet përvojë pune në fushën e vet dhe

- një anëtar me përgatitje të lartë profesionale nga fusha e shkencave shoqërore me pesë vjet përvojë pune në fushën e vet.

(5) Komisioni për kundërvajtje zgjidhet për periudhë kohore prej tre vjetësh me të drejtë të rizgjedhjes së anëtarëve.

(6) Për kryetar të Komisionit për kundërvajtje mund të zgjidhet vetëm jurist i diplomuar.

(7) Komisioni për kundërvajtje vendos për Organin për kundërvajtje mbi kundërvajtjet e përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër dhe kumton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.

(8) Krahës anëtarëve të Komisionit për kundërvajtje ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e kulturës mund të caktojë sekretar të Komisionit për kundërvajtje i cili i kryen punët administrative të Komisionit dhe zëvendësanëtarë, të cilët me përjashtim, marrin pjesë në punën e Komisionit për kundërvajtje në rast të mungesës së ndonjërit prej anëtarëve.

(9) Komisioni për kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet.

(10) Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje, me të cilat kumtohet sanksion për kundërvajtje mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

“Barazimi”

Neni 45-b

(1) Për kundërvajtjet e nenit 45 të këtij ligji, inspektorët e kulturës e kanë për detyrë që kryerësit të kundërvajtjes t’i propozojnë procedurë për barazim para se ta paraqesin kërkesën për procedurë për kundërvajtje.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet me ngritjen e procedurës për barazim, inspektori i kulturës harton procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishëm të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përkrahimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur aty për aty.

(3) Në procesverbal përcaktohet mënyra se si do të evitohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.

(4) Inspektori i kulturës në procedurën për barazim kryerësit të kundërvajtjes mund t’i japë urdhërpagesë.

(5) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën e ka për detyrë që të njëjtën ta nënshkruajë.

(6) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën i nënshkruan personi zyrtar përkatësisht personi përgjegjës i cili është hasur aty për aty gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose person tjetër zyrtar apo personi përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) të këtij neni shënohet në procesverbal.

(8) Inspektorët e kulturës e kanë për detyrë të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për epilogun e tyre.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.